



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 2046 Prot.

Tiranë, më 15.12 2022

**VENDIM**

**Nr.11, Datë 14.12.2022**

**PËR  
ORGANZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROCESIT TË PËRZGJEDHJES SË TRI  
KANDIDATURAVE PËR ANËTARIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË  
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE, PËRFAQËSUES TË STUDENTËVE,**

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve të Universitetit të Tiranës, në mbështetje të neneve 47 dhe 48 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”, me qëllim organizimin dhe zhvillimin e procesit të përzgjedhjes së tri kandidaturave për anëtarin e bordit të administrimit të universitetit të sporteve, përfaqësues të studentëve,

**VENDOSI;**

1. Përzgjedhja e tri kandidaturave që do t'i paraqiten Ministrit të Arsimit dhe Sportit për emërimin e anëtarit të Bordit të Administrimit të Universitetit të Sporteve, përfaqësues të studentëve, do të zhvillohet përmes procesit të votimit të fshehtë nga studentët e Universitetit të Sportit të Tiranës.
2. Procesi i votimit për përzgjedhjen e kandidaturave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, do të zhvillohet më datën 12. 01. 2023, deri në orën 17.00.
3. Për zhvillimin e procesit të votimit, ngrihet Qendra e Votimit në mjedisin *Salla e Konferencave*. Në Qendrën e Votimit, vendosen kutite e votimit .
4. Procesi i votimit, organizohet monitorohet dhe administrohet nga KIZ.
5. Të drejtën e pjesëmarrjes dhe të ushtrimit të votës për përzgjedhjen e tri kandidaturave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi e kanë të gjithë studentët që gëzojnë statusin e studentit në Universitetit të Sporteve të Tiranës.
6. Listat emrore të studentëve me të drejtë vote shpallen në ambientet publike të Universitetit të Sporteve të Tiranës jo më vonë se data 09.01.2023.

7. Kandidatët pjesëmarrës në procedurën e konkurrimit për përzgjedhjen e tri kandidaturave për anëtarin e Bordit të Administrimit të Universitetit të Sporteve, përfaqësues të studentëve, kanë të drejtë të organizojnë takime me studentët, në grupe dhe individuale, për prezantimin e tyre dhe të projektit/angazhimit të tyre për përfaqësimin e studentëve në Bordin e Administrimit.
8. E drejta e kandidatëve për organizimin e takimeve me studentët, në grupe dhe individuale për prezantimin e tyre dhe projektit dhe angazhimit të tyre për përfaqësimin e studentëve në Bordin e Administrimit, ushtrohet deri 24 orë para ditës së votimit.
9. Studenti ka të drejtën të votojë vetëm një herë.
10. Për ushtrimin e të drejtës së votës, studentit paraqitet në Qendrën e Votimit me një mjet identifikimi; pasaportë, kartë identiteti, certifikatë dhe ose leje drejtimi automjeti.
11. Studenti, për ushtrimin e së drejtës së votimit, duhet të përzgjedhë jo më shumë se tri emra/kandidatura, nga lista e kandidatëve që pasqyrohet në fletën e votimit.
12. Fleta e Votimit, miratohet nga KIZ. Ajo strukturohet në mënyrë që të mundësojë shprehjen e qartë të vullnetit të studentit për përzgjedhjen e tri kandidatëve të vlerësuar/preferuar prej tij. Fleta e votimit duhet të jetë vulosur në pjesën e pasme të saj, me vulën e KIZ.
13. Renditja në Fletën e Votimit e kandidatëve të miratuar për zhvillimin e procedurës së përzgjedhjes, bëhet mbi bazën e rendit alfabetik, duke ju referuar gërmës së parë të emrit të kandidatit/ve. Përbri, djathtas emrit/mbiemrit të kandidatit, modelohet dhe vendoset kutiza për shprehjen e vullnetit të/nga studentit.
14. Shenjat që do të përdoren nga studentit për shprehjen e qartë të vullnetit të tij, do të jenë çdonjë prej tri shenjave si vijon: +, x dhe √.
15. Studenti, për shprehjen e vullnetit të tij në përzgjedhjen e tri kandidaturave, duhet të vendosë brenda kutizës përkatëse, përbri çdo kandidati, njëherë prej shenjave që përcaktohen në pikën 14 të këtij vendimi.
16. Fletët e votimit, të cilat mbajnë shenja të tjera, të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 14 të këtij vendimi, konsiderohen të pavlefshme.
17. Ndalohet rreptësisht fotografimi i fletës së votimit dhe e çdo forme tjetër që cenon dhe eksponon fshehtësinë së votës së studentit.
18. KIZ merr vendimin për deklarimin e vlefshëmrisë dhe pavlefshëmrisë së Fletës/ve të Votimit, me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të tij.
19. Numrimi i fletëve të votimit dhe shpallja e rezultatit përfundimtar, bëhet nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ).

20. Tri kandidaturat që rezultojnë me numrin më të lartë të votave, përzgjidhen si kandidaturat që do t'i paraqiten Ministrit të Arsimit dhe Sportit për emërimin e anëtarit të Bordit të Administrimit të Universitetit të Sporteve, përfaqësues të studentëve.
21. Tri kandidaturat që rezultojnë me numrin më të lartë të votave, i paraqiten Rektorit për vijimin e procedurës dhe korrespondencës me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit
22. KIZ ka të drejtën për interpretimin e kësaj rregullore.

### KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

**DENIS NURIU**

**ARBEN BOZAXHIU**

**ERION BALA**

**LAURETA DERHEMI**

**BLERINA ALIAJ**

**Kryetar**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Sekretare**

